

1) Piramida e Tiranës i është ushtruar një transformimi së fundmi duke zbatuar projektin e realizuar nga studio e mëposhtme prestigjioze e arkitekturës:


A) OMA

B) MVRDV

C) UNStudio

D) Mecanoo

2) Për të skicuar me dorë të lirë këndin e ngushtë, mbi një vijë horizontale fillojmë nga një pikë **0**, duke vendosur segmentin njësi, disa herë deri tek pika **a**. Më tej, tek pika **a** ndërtojmë një vijë vertikale duke vendosur segmentin njësi disa herë, deri tek pika **b**. Bashkojmë **0** me **b**. Këndi përballë brinjës **ab** është këndi i ngushtë i kërkuar. Për të ndërtuar këndin 60° , sa segmente njësi duhen vendosur në vijën horizontale dhe sa në vijën vertikale?



A) 3 njësi dhe 5 njësi

B) 3 njësi dhe 4 njësi

C) 3 njësi dhe 6 njësi

D) 3 njësi dhe 2 njësi

3) Një klasë me 40 nxënës duhet të ndahet për një projekt në grupe të vogla me nga 3, 4 ose maksimumi 5 nxënës. Sa është numri maksimal i grupeve që mund të formohen?

A) 8

B) 12

C) 11

D) 13

4) Nëse: Elio ka lindur përpara Françeskës, e cila ka lindur përpara Gjergjit. Gjithashtu, edhe Iliri ka lindur përpara Gjergjit. Atëherë...

A) Iliri është më i vjetri në moshë.

B) Është e sigurt që Elio është më i madhi.

C) Iliri dhe Françeska kanë të njëjtën moshë.

D) Elio dhe Françeska kanë me siguri moshë të ndryshme.

5) Një ditë pyeta shokët se në cilin muaj do të vinte shfaqja e cirkut në qytet; ja si m'u përgjigjën secili prej tyre.

Beni: Ky muaj ka 31 ditë.

Aldo: Ky muaj ka 5 gërma.

Edi: Ky muaj ka dy shkronja njësoj.

Klea: Ky muaj mbaron me shkronjën R.

Tomi: Ky muaj ka dy zanore të ndryshme.

Ela: Ky muaj ka 30 ditë.

Nëse vetëm njëri prej tyre po gënjen: Cili është muaji në të cilin vjen cirku e që po flasin shokët?


A) Janar

B) Nëntor

C) Tetor

D) Korrik

6) Sa është kuota horizontale në sheshpushim në planimetrinë e dhënë të shkallëve ?



- A) -1.53 m B) +5.27 m C) +1.87 m D) +5.02m

7) Kush është krijuesi i “Modulorit”, sistemit universal të matjes i cili bazohet në proporcionet e trupit të njeriut?

- A) Ludwig Mies van der Rohe B) Le Corbusier
C) Frank Lloyd Wright D) Frank O. Gehry


8) Identifiko fjalën për t’u eliminuar si jokohereente me të tjerat:

- A) Gjarpër B) Balenë C) Lepur D) Lakuriq nate

9) Cili prej lumenjve të mëposhtëm kalon në Paris?

- A) Danubi B) Elba C) Sena D) Tamizi

10) Sa është sipërfaqja në m² e dhomës së paraqitur në plan referuar përmasimit të dollapit në cm?



- A) 11.025 m² B) 13.2 m² C) 14.4 m² D) 8.1 m²

11) Kush nga arkitektët e mëposhtëm është i njohur për realizimin e veprës “Shtëpia në kaskadë”, ilustruar më poshtë?





- A) Frank Lloyd Wright
- C) Le Corbusier

- B) Walter Gropius
- D) Alvar Alto

12) Katedralja “Notre Dame” në Paris është e stilit:

- A) Gotik
- B) Romanik
- C) Barok
- D) Të rilindjes

13) Cila nga alternativat është paraqitja me projeksione për figurën gjeometrike të dhënë në aksonometri ?




- A) 4
- B) 1
- C) 2
- D) 3

14) Cili qytet ishte qendra e artit evropian në fillimet e shekullit të 20-të?

- A) Amsterdami
- B) Londra
- C) Vjena
- D) Parisi

15) Në figurë paraqitet rruga që nisim për t'i brendashkruar rrethit:








- A) Pesëkëndorin B) Gjashtëkëndorin C) Dhjetëkëndorin D) Shtatëkëndorin

16) Në cilin prej kongreseve u vendos alfabeti, me të cilin shkruhet edhe sot gjuha shqipe?

- A) Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe B) Kongresi i Lushnjës
C) Kongresi i Manastirit D) Kongresi i Përmetit

17) Cila është kutia që mungon?



- A)  B)  C)  D) 

18) Pushtimi i Kostandinopojës nga Perandoria Osmane ndodhi në:

- A) 1590 B) 1744 C) 1321 D) 1453

19) Regjizor i cilit prej filmave të mëposhtëm është Dhimitër Anagnosti?

- A) I dashur armik B) Përrallë nga e kaluara
C) Vdekja e kalit D) Koncert në vitin 1936

20) Kush është autori i veprës “Motra Tone”, ilustruar në figurën më poshtë?

- A) Kolë Idromeno B) Alush Shima C) Ibrahim Kodra D) Vangjush Mio

21) Cila nga urat e mëposhtme nuk i përket ndërtimeve të mesjetës?

A) Ura e Mesit, Shkodër

B) Ura e Zogut, Milot

C) Ura e Golikut, Pogradec

D) Ura e Bratajt, Vlorë

22) Një litër lëng në temperaturën 10°C përzihet me gjysmë litri të të njëjtit lëng me temperaturë 40°C . Temperatura e ekuilibrit është:






A) 20°C

B) 30°C









C) 40°C

D) 25°C

23) Cila është kutia që mungon?




24) Lidhni paraqitjen me projeksione me paraqitjen aksonometrike përkatëse të trupit gjeometrik.



A) 3B, 4A, 5E, 6F, 1C, 2D
C) 5B, 6E, 3D, 4C, 1F, 2A

B) 4C, 5E, 6F, 1D, 2B, 3A
D) 2C, 3F, 4D, 5E, 6A, 1B



25) Imazhi më poshtë ilustron:




A) Një zigurat
C) Një piramidë

B) Një obelisk
D) Asnjë nga alternativat më sipër


26) Cila nga paraqitjet është projeksioni i saktë në horizontal i trupit të prerë me dy plane?




1



2



3



4

A) 2

B) 4

C) 3

D) 1

27) Cili nga çiftet e mëposhtme të fjalëve plotëson saktë fjalinë: “Ndonëse njihej si person, fjalimi i tij në kongres ishte shumë”?

A) i drejtë, jokorrekt

B) erudit, brilant

C) i ndrojtur, i nënshtruar

D) inteligjent, kritik

28) Nëse është e vërtetë që të gjithë lapsat që kam janë të kuq përveç dy prej tyre, të gjithë lapsat që kam janë blu përveç dy prej tyre, të gjithë lapsat që kam janë të zinj përveç dy prej tyre, sa lapsa kam?

A) Dy

B) Tre

C) Katër

D) Një

29) Cila nga veprat e mëposhtme nuk është e Leonardo da Vinci-t?

A) “Njeriu Vitruvian”

B) “Mona Lisa”

C) “Kapela Sistine”

D) “Darka e fundit”

30) Zgjidh alternativën, e cila rendit objektet sipas lartësisë në metra, duke filluar nga objekti me lartësi më të ulët:

A) Piramida e madhe, Gizë; Kulla Eiffel, Paris; Ndërtesa “Empire State”, New York; One World Trade Center, New York

B) Kulla Eiffel, Paris; Piramida e madhe, Gizë; Ndërtesa “Empire State”, New York; One World Trade Center, New York

C) Kulla Eiffel, Paris; Piramida e madhe, Gizë; One World Trade Center, New York; Ndërtesa “Empire State”, New York

D) Piramida e madhe, Gizë; Kulla Eiffel, Paris; One World Trade Center, New York; Ndërtesa “Empire State”, New York

31) Në shkallën 5:1, në cilën përmasë do të vizatohej segmenti 2 cm?

A) 0.4 m


B) 10 cm

C) 2.5 cm

D) 1 m

- 32) Një trup lihet të bjerë vertikalisht nga prehja nga një lartësi e caktuar dhe fiton në fund të lëvizjes një energji kinetike E . Sa bëhet energjia kinetike nëse masa e trupit dyfishohet?
- A) $4E$ B) $2E$ C) E D) $E/2$

- 33) Në figurë paraqitet rrafshi në aksonometri. Cila nga alternativat e dhëna paraqet projeksionet e sakta të tij?





- 34) Cili nga vendet e mëposhtme nuk bën pjesë në zonën Shengen?
- A) Mbretëria e Bashkuar B) Islanda
 C) Finlanda D) Zvicra

- 35) Gjeni si mund të vazhdojë sekuenca e mëposhtme:

2 — 3 — 5 — 9 — 17 — 33 — ...

A) 99 B) 67 C) 65 D) 56

36) Është dhënë trupi në aksonometri. Përcaktoni dy projeksionet që i mungojnë tek paraqitja me projeksione.



- A) V-2; W-4 B) V-5; W-6 C) V-1; W-3 D) V-3; W-4

37) Cilat shkronja duhet të zëvendësojnë pikëpyetjen?

HË	MA
MË	ENJ
PR	SHT
DI	?

- A) SHT B) HË C) DI D) MA

38) Një kuti është e ndarë në pesë nëndarje drejtkëndore të barabarta të vendosura në mënyrë të tillë që brinja gjatësore e një nëndarjeje është në kontakt me 4 brinjët anësore të katër nëndarjeve të tjera. Perimetri i kutsisë është 144 cm. Cilat janë dimensionet në centimetra të një nëndarjeje?

- A) 8 x 32 B) 9 x 36 C) 6 x 24 D) 7 x 28

39) Cili është autori i romanit “Harku i Triumfit”?

- A) Ismail Kadare B) Stefan Zweig
C) Mark Twain D) Erich Maria Remark

40) Cilat nga veprat arkitektonike të mëposhtme nuk është vepër e Antoni Gaudít?

- A) Kisha “Sagrada Familia” B) Shtëpia Milà
C) Parku Güell D) Pavijoni i Barcelonës

41) Nga veprat e mëposhtme përzgjidh atë që nuk i përket piktorit Pablo Picasso.



A)



B)



C)



D)

42) Për cilin nga zhanret e pikturës njihet më shumë artisti i njohur shqiptar Vangjush Mio?

A) Peizazhin

B) Portretin

C) Figurat nudo

D) Natyrën e qetë

43) Në një kuti ka 4 zara të bardhë, 3 zara të verdhë dhe 7 zara jeshilë. Sa është probabiliteti që të nxjerrim nga kutia në mënyrë rastësore, një zar të bardhë ose një zar jeshil?

A) $11 / 14$

B) $1 / 14$

C) $4 / 14$

D) $1 / 2$

44) Në fletët e vizatimit teknik të një objekti apo detaji vendoset si rregull shkalla e vizatimit. Kur ajo është shënuar 2:1, tregon:






A) Shkallë kopjimi.

B) Shkallë zmadhimi.

C) Shkallë zvogëlimi.

D) Shkallë natyrale.

45) Cila është kutia që mungon?



46) Përmasat e formatit A6 të vizatimit janë:


- A) 105 mm x 148 mm
C) 106 mm x 149 mm

- B) 105 mm x 149 mm
D) 106 mm x 148 mm

47) Tapeti i një dhome është i ngjyrosur në këtë mënyrë: 1/3 është me ngjyrë të zezë, 1/4 me ngjyrë të kuqe, ndërsa pjesa tjetër me ngjyrë të bardhë përbën 8 metra katrorë. Sa është sipërfaqja e tapetit nëse e shënojmë me X?

- A) $X=96/5$ metra² B) $X=5/12$ metra² C) $X= 96$ metra² D) $X=8$ metra²

48) Sa është lartësia e një këmbë shkalle në prerjen e dhënë, kur lartësia e katit është 3.24m ?



A) 17 cm

B) 17.5 cm

C) 18.5 cm

D) 18 cm

49) Cilët numra duhet të zëvendësojnë pikëpyetjet?

4	7	1
5	1	3
9	8	4

A) 5 1 4

5	1	3
2	8	5
7	9	8

B) 4 1 8

1	2	6
2	9	2
?	?	?

C) 6 2 4

D) 3 1 8

50) Merret një copë letër dhe paloset më dysh për tre herë rradhazi dhe pastaj i bëhet një vrimë në mes me majën e një lapsi. Kur e hapim letrën, sa vrima do të jenë në të?

A) 6

B) 1

C) 8

D) 3

51) Cili prej kombinimeve të mëposhtme nuk është i saktë:

A) Violeta Manushi-aktore

B) Ibrahim Kodra-shkrimtar

C) David Selenica-piktor

D) Petro Marko-shkrimtar

52) Cili kryeqytet europian nuk u pushtua nga nazistët gjatë Luftës së Dytë Botërore?


A) Roma

B) Parisi


C) Moska

D) Praga


53) Cili prej trupave në aksonometri korrespondon me paraqitjen në dy projeksione në V dhe H ?



A) 1




B) 3



C) 4



D) 2



54) Vepër e kujt artisti është piktura e titulluar “Lulëzimi i pemës së bajames”, ilustruar në figurën mëposhtë?







A) Paul Cézanne

B) Paul Gauguin

C) Henri Matisse

D) Vincent van Gogh

59) Plotësoni saktë pamjen e tretë në paraqitjen me projeksione të trupit gjeometrik.



A) 2

B) 1

C) 3

D) 4

60) Një djalë me motor ndjek shokun, i cili është me biçikletë. Pas sa kohe takohen, nëse shpejtësia e dy mjeteve është respektivisht 40km/h dhe 20km/h dhe në çastin e dhënë janë 500m larg njëri tjetrit?

A) 1 orë

B) 60 sekonda

C) 90 sekonda

D) 3 minuta

Answer Key

Testname: UNTITLED1

- 1) B
- 2) A
- 3) D
- 4) D
- 5) C
- 6) B
- 7) B
- 8) A
- 9) C
- 10) C
- 11) A
- 12) A
- 13) C
- 14) D
- 15) C
- 16) C
- 17) D
- 18) D
- 19) B
- 20) A
- 21) B
- 22) A
- 23) D
- 24) C
- 25) A
- 26) A
- 27) A
- 28) B
- 29) C
- 30) A
- 31) B
- 32) B
- 33) B
- 34) A
- 35) C
- 36) C
- 37) B
- 38) A
- 39) D
- 40) D
- 41) B
- 42) A
- 43) A
- 44) B
- 45) D
- 46) A
- 47) A
- 48) D
- 49) B
- 50) C
- 51) B
- 52) C
- 53) C
- 54) D

Answer Key

Testname: UNTITLED1

55) A

56) B

57) A

58) D

59) B

60) C